


# Aksidentet Rrugore

## Tetor 2017

**Tiranë, më 20 Nëntor 2017:** Në muajin Tetor 2017 numërohen 184 aksidente rrugore nga 193 aksidente të ndodhur në Tetor 2016. Në krahasim me Tetor 2016, numri i aksidenteve është ulur me 4,7 %.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Tetor 2013 - Tetor 2017



Numri i të aksidentuarve është 223 persona, nga 257 që ishte një vit më parë, për të njëjtën periudhë.

Në dhjetëmujorin 2017, numri i të aksidentuarve është ulur 6,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i personave të plagosur gjatë muajit Tetor 2017 është 203, nga 230 persona të plagosur në Tetor 2016. Krahasuar me mesataren e personave të plagosur gjatë vitit 2016, ky numër është ulur me 2,9 %.

Në Tetor 2017, aksidentet rrugore, në 82,6 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit.

Në dhjetëmujorin 2017, aksidentet rrugore të cilat kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit zënë 81,5 % të rasteve. Numri më i lartë i aksidenteve është kryer nga grup-mosha 25 – 35 vjeç, duke zënë 27,7 % të numrit të aksidenteve rrugore dhe duke u ulur me 6,5 % me njëjtën periudhë të një viti më parë. Në Tetor 2017, numri i të vdekurve nga aksidentet për 100.000 banorë ishte afërsisht 1 person.

**Tab. 1 Aksidentet rrugore, Tetor 2017**

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
Tetor - 2016	193	7	20	55	175	
Tetor - 2017	184	2	18	59	144	
Ndryshimi vjetor (%)	-4,7	-71,4	-10,0	7,3	-17,7	
Janar - Tetor 2016	1.695	45	183	660	1.466	
Janar - Tetor 2017	1.669	28	158	607	1.413	
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-1,5	-37,8	-13,7	-8,0	-3,6	

**Tab. 2 Aksidentet rrugore sipas përdoruesve të rrugës, Tetor 2017**

Periudha	Aksidente sipas		Të vdekur sipas	
	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve
Tetor - 2016	154	39	20	7
Tetor - 2017	152	32	14	6
Janar - Tetor 2016	1.447	248	183	45
Janar - Tetor 2017	1.360	309	149	37

**Tab. 3 Aksidentet rrugore sipas moshës së drejtuesit të mjetit, Tetor 2017**

Periudha	Aksidente sipas moshës së drejtuesit të mjetit						Larguar nga vendi i ngjarjes
	0 - 16 vjeç	16 - 25 vjeç	25 - 35 vjeç	35 - 45 vjeç	45-60 vjeç	60+ vjeç	
Tetor - 2016	0	40	61	33	34	13	12
Tetor - 2017	1	36	46	33	36	18	14
Janar - Tetor 2016	13	339	494	275	341	127	106
Janar - Tetor 2017	5	361	462	273	326	143	99

**Tab. 4 Aksidentet rrugore sipas qarqeve, Tetor 2017**

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Tetor-2016	Tetor-2017	Tetor-2016	Tetor-2017	Janar-Tetor 2016	Janar-Tetor 2017	Janar-Tetor 2016	Janar-Tetor 2017
Shqipëria	193	184	27	20	1.695	1.669	228	186
Tiranë	80	79	8	10	617	647	55	41
Durrës	12	20	6	2	219	222	32	22
Shkodër	22	4	2	2	110	42	22	20
Elbasan	10	13	0	0	124	137	15	16
Fier	15	11	3	1	123	101	21	25
Vlorë	10	14	0	0	82	118	11	10
Korçë	13	11	4	1	120	86	19	12
Lezhë	16	18	0	2	166	182	24	22
Berat	3	2	0	0	44	36	5	1
Kukës	5	3	2	2	37	33	6	5
Dibër	5	5	1	0	27	34	7	1
Gjirokastrë	2	4	1	0	26	31	11	11

# Përkufizime

**Aksidente:** Aksidentet rrugore që ndodhin tek një ose më shumë persona që goditen nga mjetet e qarkullimit rrugor.

**I vdekur:** I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit.

**I plagosur:** I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit.

**Sjellja e Drejtuesit të Mjetit :** Nënkupton nëse drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: frenim i papritur, injoron shenjat (sinjalistikën) e trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë etj.

**Sjellja e Këmbësorëve:** Nënkupton nëse këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si : kalim rrugë pa kujdes, etj.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

*Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx> Politika e revizionimit statistikor.*